PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më **16.2.2023,** me fillim në orën **10:00.** Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Defrim Kafexhiu**.

Kryesuesi: Fillimisht më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve, Nënkryetarin **Fatmir Iska**, Drejtorët e drejtorive. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit shumë për pjesëmarrjen! E hapim mbledhjen e 2-të të **Komitetit për Politikë dhe Financa** për vitin 2023.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë:

REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i propozim - vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.406/22, i datës 28.12.2022, për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban 2022 - 2027;**
3. **Shqyrtimi i propozim - vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.404/22, i datës 28.12.2022, për miratimin e Planit të Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera për Komunën e Rahovecit;**
4. **Shqyrtimi i propozim - vendimit për faljen e borxheve të papaguara për taksat në aktivitete (afariste), nga data 1.1.2000– 31.1.2017;**
5. **Shqyrtimi i propozimit për caktimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe të zëvendësdrejtorëve në institucionet edukativo - arsimore;**
6. **Shqyrtimi i propozim - vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2022, në vitin 2023;**
7. **Shqyrtimi i propozim - vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik P-01952-1, zona kadastrale Ratkoc;**
8. **Shqyrtimi i propozim - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale P-01952-1;**
9. **Shqyrtimi i propozim - vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë P-02240-73, zona kadastrale - Rahovec;**
10. **Shqyrtimi i propozim - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale P-02240-73;**
11. **Shqyrtimi i propozim - vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit, të fshatit Kramovik P-00330-0;**
12. **Shqyrtimi i propozim - vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë; - P – 00722-0;**
13. **Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike - 2022 - kontratat kornizë;**
14. **Informatë mbi menaxhimin e aseteve për vitin 2022;**
15. **Informatë nga DKA-ja për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023;**
16. **Të ndryshme.**

Kryesuesi: Nëse dikush prej anëtarëve të KPF-së ka diçka për të thënë lidhur me rendin e ditës për sot.
Isak Hoti: Përshëndetje kryesues, nënkryetar, delagatë të nderuar! MAPL-ja e ka kthyer dje Rregulloren për Taksa Komunale që e kemi votuar në mbledhjen që shkoi. Në mbledhjen e radhës të kuvendit, e kemi si obligim ta fusim në rend të ditës. Përkatësisht arsyeja ishte rreth mungesës së taksës për shërbim profesional për prerjen e pyjeve. Ne duhet t'i shtojmë edhe dy pika. Ndyshimin e rregullores bazike (nenin 34) dhe plotësim - ndyshimin e nenit 12. Kështu, kisha kërkuar që kjo pikë të futet në rend dite dhe të bartet në kuvend. Ndyshimi dhe plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale.
Kryesuesi: Atëherë, përveç pikave të rendit të ditës që i lexova, i kemi edhe **4 pika shtesë:**
Shfuqizimi i vendimit 149/2006, i datës 14.7.2023; pika tjetër është: **Marrja e vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private në zonën kadastrale në Xërxë;** pika e tretë është: **Aprovimi i Planit të Punës të Komunitetit për Komunitete për 2023** dhe pika e katërt është**: Plotësim - ndyshimi i Rregullores Bazike për Taksa komunale.**
A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment rreth këtyre propozimeve?... Si të tilla po i vendosim në votim. Kush është "për"?... Me shumicë votash, shtohen edhe këto 4 pika në rend dite dhe rendi i ditës bëhet me 20 pika. Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, kush është "për"?... Me shumicë votash miratohet edhe rendi i ditës për mbledhjen e sotme.
1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
Kryesuesi: A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Me shumicë votash, miratohet procesverbali.
2. Shqyrtimi i propozim - vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.406/22, i datës 28.12.2022, për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban 2022 - 2027;
Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, pas marrjes së vendimit të kuvendit për Planin e Mobilitetit, duke iu referuar 8 ligjeve në fuqi që kanë qenë në Plan, Ministria e Infrastrukturës na ka rekomanduar që 3 ligje detyrimisht të futen. Në kuvend të bëhet plotësim - ndryshimi i tri ligjeve. Kam kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës që, së paku, para mbledhjes së kuvendit, të na kthejnë dokumentin që është gjithçka në rregull, para marrjes së vendimit.
Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Me shumicë votash votash aprovohet pika e dytë e rendit të ditës.
3. Shqyrtimi i propozim - vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.404/22, i datës 28.12.2022, për miratimin e Planit të Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera për Komunën e Rahovecit;
Përparim Krasniqi: Ky dokument është i pari që po implementohet në Kosovë dhe Agjencia e Menaxhimit Emergjent kërkon që së paku ta japë një vlerësim profesional për punën e këtij vlerësimi të rreziqeve.
Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Me shumicë votash votash aprovohet pika e tretë e rendit të ditës.
4. Shqyrtimi i propozim - vendimit për faljen e borxheve të papaguara për taksat në aktivitete (afariste), nga data 1.1.2000 – 31.1.2017;
Erhan Morina: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni propozimin – vendimin për faljen e borxheve të papaguara në taksa afariste për të gjitha bizneset që funksionojnë nga janari i vitit 2000, deri më 31 janar 2017. Në pamundësi për t'i inkasuar borxhet e akumuluara ndër vite, Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm propozon faljen e tyre me qëllim që ky borxh i "keq" mos ta ngarkojë performancën komunale.
Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment rreth kësaj pike?... Përndryshe unë e kam një propozim, që në materialin e bashkëngjitur për kuvend, të shkruhet vlera totale që do të falet.
Erhan Morina: Vlera e këtyre borxheve në fund të vitit 2022 ka qenë 633,713 euro, ndërsa vlera e borxhit që do të falet është rreth 590.000 euro.
Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment rreth kësaj pike?... Nëse jo, po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e katërt e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i propozimit për caktimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorit/es dhe të zëvendësdrejtorit/es në institucionet edukativo - arsimore;

Avni Morina: Faleminderit kryesues! Caktohet komisioni për përzgjedhjen e drejtorit/es dhe zëvendësdrejtorit/es së institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP) në Komunën e Rahovecit, që kanë konkururar në konkurset e shpallura nga Drejtoria për Arsim, në këtë përbërje: Ardit Halilaj, Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë, në Drejtorinë për Arsim, kryesues; Erseka Cana, kryetare e Këshillit të Prindërve, anëtare; anëtari i tretë vjen nga MASH-i sipas UA Nr. 151/2020, i datës 22.12.2020.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment rreth kësaj pike?... Nëse jo, po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e pestë.

6. Shqyrtimi i propozim - vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2022, në vitin 2023;

Afrim Limani: Faleminderit kryesues! E keni para jush propozim - vendimin për bartjen e mjeteve vetanake nga 2022 në 2023. Për të mos i humbur këto mjete, kërkojmë nga ju që këtë pikë ta bartim për diskutim në kuvend.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Me shumicë votash aprovohet pika e gjashtë.

7. Shqyrtimi i propozim - vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik P-01952-1, zona kadastrale Ratkoc;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! Sipas ligjeve në fuqi, e keni propozim – vendimin, për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik P-01952-1, bëhet fjalë për zonën kadastrale në Ratkoc.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Me shumicë votash aprovohet pika e shtatë.

8. Shqyrtimi i propozim - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale P-01952-1;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! E kemi shqyrtimin e propozim - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale me numër P-01952-1, komisioni do t'i ketë 5 anëtarë, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe një nga shoqëria civile.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Me shumicë votash aprovohet pika e tetë.

9. Shqyrtimi i propozim - vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë P-02240-73, zona kadastrale - Rahovec;

Afrim Oruqi: Prona gjendet në zonën kadastrale në Rahovec, jepet në shfrytëzim në afat prej 15 vitesh dhe i posedon 2 hektarë, 50 ari e 99 metra katror. Qëllimi është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës komunale për turizëm. Po vazhdoj edhe me pikën e 10-të që lidhet me këtë pikë.

10. Shqyrtimi i propozim - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale P-02240-73;

Afrim Oruqi: Kryetari i Komunës, i propozon KPF-së vendimin për caktimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, bëhet fjalë për të njëjtën parcelë, në qytet, afër Majës së Shkodranit. Formohet komisioni që pastaj i zbaton obligimet që burojnë prej akteve ligjore, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe një nga sektori i shoqërisë civile. Ftoj anëtarët e KPF-së, pas shqyrtimit, t'i votojnë veç e veç këto dy pika të rendit të ditës.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka lidhur me pikën e 9-të të rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash, aprovohet pika e 9-të. Poashtu ftoj anëtarët e KPF-së, për ndonjë koment për pikën e 10-të?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash, aprovohet edhe pika 10-të.

11. Shqyrtimi i propozim - vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit, të fshatit Kramovik P-00330-0;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! Bëhet fjalë për një kërkesë që ka ardhur prej kësilmit të fshatit Krahovik. Parcela gjendet në atë zonë, është pronë shoqërore KK- Rahovec (77 ari e 68m katror). Kryesia ka kërkuar prej neve të marrim një vendim dhe prej kësaj parcele t'iu ndajmë 4 ari, që pastaj ata, në bashkëpunim me komunën, të ndërtojnë një objekt për nevojat e komunitetit për aktivitete kulturore.

12. Shqyrtimi i propozim - vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë; - P – 00722-0;

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për një propozim - vendim për caktimin e lokacionit për zonë kadastale në Polluzhë, përafërsisht me të njëjtën tematikë, P – 00722-0 me 16 ari e 89m katror. Kryesia e fshatit ka kërkuar prej neve që t'iu ndajmë 2 ari për ndërtimin e një objekti për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka lidhur me pikën e 11-të të rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash, aprovohet pika e 11-të. Poashtu ftoj anëtarët e KPF-së për ndonjë koment për pikën e 12-të?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash, aprovohet edhe pika 12-të.

13. Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike 2022 - kontratat kornizë;

Astrit Mullabazi: Faleminderit kryesues! Në bazë të raportit vjetor, kontratat e nënshkruara publike, kontrata kornizë për vitin 2022, janë gjithsej 27 të tilla. Kontratat kornizë bëhen në bazë të rregullores të udhëzuesit operativ të prokurimit publik, sipas nenit 56 të ligjit.

Kryesuesi: Faleminderit Astrit! A ka dikush diçka lidhur me kontratat kornizë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 13-të.

14. Informatë mbi menaxhimin e aseteve për vitin 2022;

Erhan Morina: Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm çdo vit kalendarik, si pikë informuese për kuvendin, përgatit informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale. Janë formuar këto komisione: komisioni për regjistrimin e pasurive jofinanciare, komisioni për inventarizim të pasurive jofinanciare, komisioni për tjetërsim të pasurive jofinanciare dhe komisioni për asgjësimin e pasurive jofinanciare. Të gjitha këto komisione punën e kanë kryer me kohë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka lidhur me informatën për menaxhimin e aseteve për vitin 2022?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash, aprovohet edhe pika e 14-të.

15. Informatë nga DKA-ja për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023;

Avni Morina: Në këtë informatë, kam paraqitur të gjitha aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023. Me vendim të Ministrisë, periudhat janë kthyer përsëri me metodën e vjetër (2 periudha). Në informatë kam treguar faktin që për ndyshim nga vitet tjera, ky vit nuk ka filluar me kohë, ka filluar me 3 tetor 2022, për shkak të grevës që ishte e organizuar nga sindikalistët. Kam cekur faktin që, edhe pse është kërkuar ka Ministria e Arsimit për zëvendësimin e orëve të humbura, kjo gjë nuk ka ndodhur. Në mënyrë kronologjike, kam paraqitur të gjitha aktivitetet që kanë ndodhur prej 3 tetorit, deri me 27 janar.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka lidhur me informatën e DKA-së?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash, aprovohet edhe pika e 15-të.

16. Shqyrtimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01Nr. 149/2006, i datës 14.7.2006;

17. Shqyrtimi i vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private në zonën kadastrale në Xërxë, P- 01041-1;

18. Aprovimi i Planit të Punës të Komunitetit për Komunitete për 2023;

19. Plotësim - ndyshimi i Rregullores Bazike për Taksa komunale;

Kryesuesi: Të gjitha pikat shtesë (katër), janë votuar për të kaluar në seancën e rregullt të kuvendit.

Kryesuesi: Jemi te pika e fundit. Nëse dikush ka diçka për të shtuar, apo ndonjë çështje për diskutim?... Nëse jo, atëherë po e mbyllim mbledhjen e dytë të KPF-së për vitin 2023. Shihemi në seancën e rregullt.

Mbledhja përfundoi: 10:40

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Defrim Kafexhiu